

Andrea Llukani
Muzeu Historik Kombëtar

NDIHMESA E THEOFAN POPËS PËR MUZEOLOGJINË SHQIPTARE

Hyrje

Theofan Popa ka lindur më 3 nëntor të vitit 1914, në lagjen Kala të Elbasanit në një familje zanatçinsh. Pasi përfundoi shkollën fillore Kostandin Kristoforidhi, me ndërhyrjen e atë Josif Mihalit mundi të sigurojë një të drejtë studimi për në Seminarin Teologjik “Joan Teologu” në Manastir¹. Pasi përfundoi seminarin në vitin 1936 u kthye në Shqipëri dhe pas një viti me mbështetjen e Kryepeshkopit Visarion Xhuvani mundi të shkonte për të ndjekur studimet e larta në Fakultetin Teologjik të Universitetit Kapodistria të Athinës, në vitin akademik 1937-1938, me bursë nga fondacioni Jovan Banka².

¹ Në Seminarin “Jovan Teologu” të Bitolit kanë studiuar rreth 40 shqiptarë; Millosh Gjergj Nikolla, Vasil Shanto, Jordan Misja, Aleksandër Xhuvani, Lasgush Poradeci, Kostaq Cipo, Theofan Popa, Petro Doçi, Pavlo Topuzi, Pandeli Papaanastasi etj. Nasho Jorgaqi, *Udhëve të mërgimit*, Albin, Tiranë 1994, faqe 104-105, 123, 125.

² Alma Gjermani, *Dhuruesit korçarë të shek. XIX*, Tempulli, Nr. 13, Korçë 2008, faqe 18-20.

Ndërkohë në Shqipëri ndodhën ndryshime të mëdha përsa i përket organizimit kishtar. Më 12 prill 1937, Patriarkana Ekumenike shpalli autoqefalinë e Kishës Ortodokse të Shqipërisë dhe Kryepeshkop i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë u zgjodh Kristofor Kisi. Sapo përfundoi vitin e parë të fakultetit, Theofani mori një letër nga Kryepeshkop Kisi, me anën e së cilës i thuhej se duhej t’i ndërpriste studimet në Athinë, për t’i vazhduar në Kolegjin Anglikan “Ngjallja e Krishtit” në Londër. Pasi qëndroi vetëm disa muaj në Londër (gusht-tetor 1938) u kthye në Athinë për të vazhduar studimet, të cilat i përfundoi në vitin 1941. U kthye në atdhe më 1942 dhe filloi punë në Liceun e Korçës si profesor i gjuhës latine. Më 1945 Theofan Popa u transferua në Tiranë ku punoi si predikues dhe artikullshkrues pranë Kryesisë së Kishës Ortodokse³. Theofani botonte një buletin dyjavor me predikimet e të dielave, i cili u dërgohej kishave ortodokse të Shqipërisë. Në korrik të vitit 1945 u themelua Lidhja e Teologëve dhe e Seminaristëve të K.O.A.Sh-it, e cila zgjodhi si kryetar të saj teologun Theofan Popa⁴. Për disa motive, të cilat kanë mbetur ende enigmë, në vitin 1947, Theofanin e larguan nga kisha⁵. Sipas një raporti të sigurimit të shtetit arsyeja e largimit të Theofan Popës nga kisha ka qenë konflikti që ka pasur me Sekretarin e Përgjithshëm të K.O.A.Sh-it Z. Niko Çane⁶.

³ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Dosje formulare, Nr. 3328, faqe 49.

⁴ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Dosje formulare, Nr. 3328, faqe 16.

⁵ Dhimitër Beduli, *Theofan Popa-teolog dhe studiues i denjë i kishës dhe i kombit*, Ngjallja, janar 1995, faqe 6,8.

⁶ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Dosje formulare, Nr. 3328, faqe 108.

Veprimtaria në mbledhjen e mbishkrimeve dhe objekteve liturgjike kishtare

Në vitin 1949 Theofani u sistemua në Institutin e Shkencave, në Sektorin e Historisë së Mesjetës, ku e ngarkuan të merrej me studimin e ikonave dhe të afreskeve kishtare. Duke bashkëpunuar ngushtë me bizantinologen ruse Viktori Puzanova, Theofani punoi me zell për evidentimin dhe sistemimin e mbishkrimeve kishtare. Gjatë viteve 1950-1967, falë njohurive të thella teologjike, që kishte marrë në Universitetin Kapodistria të Athinës, Theofan Popa u mor me deshifrimin e mbishkrimeve të vjetra nëpër kisha, ikonostase, amvone, ikona etj. Punën për evidentimin e mbishkrimeve murale dhe të ikonave e filloi me kishën e Shën Stefanit në Himarë dhe në vijim, me trapezarinë e manastirit të Apolonisë⁷, kishën e Shën Mërisë së Vllahernës në Berat etj. Në vitin 1951 shkoi në zonën e thellë malore të Shpatit në rrethin e Elbasanit, në kishën e Shën Nikollës në Seltë, në kishën e Shën e Premtes në Valësh, ku zbuloi mbishkrimet e Onufrit⁸. Më 1953 vizitoi

⁷ Theofan Popa, *Saktësime rreth datimit të kishës së manastirit të Apolonisë*, Studime historike, Nr. 1, 1967, faqe 137-144.

⁸ Theofan Popa, *Onufri, piktor i madh shqiptar i shek. XVI*, Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencat Shoqërore, Nr. 1, 1955, faqe 208-219; Theofan Popa, *Onufri, piktori më i madh shqiptar i shek. XVI*, Puna, 18 tetor, 1960; Theofan Popa, *Onufri, piktori më i madh mesjetar në Shqipëri*, Zëri i Rinisë, 28 tetor, 1961; Theofan Popa, *Piktor Onufri dhe gjendja e artit të pikturës gjatë mesjetës*, Nëntori, Nr. 4, 1962; Theofan Popa, *Onufri, ikonograf i shquar shqiptar*, Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencat Shoqërore, Nr. 1, 1962, faqe 54-75; Theofan Popa, *Të dhëna të reja rreth piktor Onufrit*, Studime historike, Nr.1, 1966, faqe 141-145; Theofan Popa, *Piktor Onufri, personalitet i rëndësishëm i pikturës mesjetare shqiptare*, Studime shqiptare, Nr. 1, 1966; Theofan Popa, *Rreth veprës së Onufrit*, Monumente të kulturës në Shqipëri, Nr. 2, 1975, faqe 72-74; Theofan Popa, *Onufri dhe biri i tij, Nikolla*, Ngjallja, shtator 1995, faqe 9.

kishën e Shën Kollit në Voskopojë, ku zbuloi veprën ikonografike të David Selenicës⁹. Në vitin 1954 u mor me piktorin Kostandin Shpataraku¹⁰, i cili ka pikturuar kishën e Shën e Premtes në Çetë të Kavajës, kishën e manastirit të Shën Gjon Vladimirit në Elbasan, kishat e Vithkuqit etj. Më 1955 shkoi në zonën e Myzeqesë e vizitoi kishat e fshatrave Vanaj, Karavasta, Bishtqethëm, Kadipashaj, Kozarë, Krutje, Toshkëz etj., ku gjeti ikona dhe mbishkrime të vëllezërve Çetiri¹¹. Më pas shkoi në veri të Shqipërisë, ku vizitoi kishën e Rubikut dhe kishën e Vaut të Dejës. Pastaj vizitoi kishën e Shën Mërisë në Maligrad të Prespës, kishën e Riztozit¹² në Mborje të Korçës etj.

Theofan Popa e kundërshtoi prishjen e shumë kishave, që mbanin statusin “Monument kulture”. Ai gjithmonë theksoi rëndësinë e tyre për trashëgiminë tonë kulturore¹³. Së bashku me kolegët Gani Strazimiri, Aleksandër Meksi dhe Pirro Thomo arritën të shpëtonin rreth 120 kisha dhe manastire, duke u dhënë statusin e monumentit të kulturës¹⁴.

⁹ Theofan Popa, *Të dhëna të reja në artin shqiptar të shek. XVIII-vepra e David Selenicasit*, mars 1969 (dorëshkrim i pabotuar); Theofan Popa, H. Nallbani, Rreth krijimtarisë së piktorit David Selenicasi, Monumentet, Nr. 2, Tiranë, 1971, faqe 167-169.

¹⁰ Theofan Popa, *Piktor Kostandini prej Shpati*, Buletin për shkencat shoqërore, Nr. 1, 1955, faqe 211-214; Theofan Popa, *Kostandin Shpataraku, piktori shqiptar i shekullit XVIII*, Nëntori, Nr. 3, 1965.

¹¹ Theofan Popa, *Piktorët grabovarë Çetiri nga familja Katro*, Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencat Shoqërore, Nr. 3, 1960, faqe 121-145.

¹² Theofan Popa, *Disa mbishkrime të kishave të Shën Mërisë në Maligrad dhe të Riztozit në Mborje*, Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencat Shoqërore, Nr. 2, 1959, faqe 257-262.

¹³ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Dosje formulare, nr. 3328, faqe 59.

¹⁴ Andi Rëmbeci, *Botime të mbishkrimeve kishtare në Shqipëri*, Kërkim, Tiranë, 2010, faqe 136.

Theofan Popa ka një veprimtari të gjerë kërkimore e shkencore për evidentimin e vlerave historike të monumenteve të kulturës së popullit shqiptar. Pas ndalimit të lirisë fetare më 1967, Theofani pati privilegjin që të siguronte një leje nga Universiteti i Tiranës për t'u marrë me kishat mesjetare të Shqipërisë. Ndërmjet viteve 1967-1975, Theofani u mor me grumbullimin e ikonave dhe të objekteve liturgjike kishtare, duke i shpëtuar ato nga shkatërrimi. Duke shkuar fshat më fshat dhe kishë më kishë, në shoqërinë e shoferit Ilia Nemçe, Theofan Popa arriti të mblidhte qindra ikona dhe objekte liturgjike kishtare. Gjithë këtë vëllim pune, sipas Pirro Thomos, Theofani e përballoi pothuajse i vetëm. Vetëm dikush që e di vendodhjen e kishave dhe në çfarë kushtesh janë mbledhur ikonat dhe objektet liturgjike, mund të çmojë punën kolosale që ka bërë Theofan Popa.

Ndihmesa e Theofan Popës për muzeologjinë shqiptare

1-Me ikonat dhe objektet liturgjike kishtare të mbledhura nga Theofan Popa¹⁵, më 26 prill 1980, u hap në Korçë Muzeu i Artit Mesjetar. Muzeu u ngrit në mjediset e kishës “Burimi Jetëdhënës”¹⁶. Ikonat qenë grumbulluar nga kishat e rrethit të Korçës në xhaminë e Mirahorit dhe prej aty u transportuan në

¹⁵ Andrea Llukani, *Kontributi i Theofan Popës për muzeologjinë shqiptare*, Le Radici, Anno 16, n. 3, Settembre 2018, pagina 16.

¹⁶ Kisha “Burimi Jetëdhënës” është ndërtuar në vitin 1707. Këtë fakt e vërteton mbishkrimi: “Ky tempull i Burimit Jetëdhënës u ndërtua në vitin shpëtimtar 1707, në kohën kur ishte peshkop i gjithëshmi mitropolit i Korçës dhe i Selasforit Joasafi, në kohën e kujdestarisë së ktitorëve të saj, Markut, Haxhi Kostës dhe Siamit. Piktoret Kostandini dhe Athanasi e kanë pikturuar atë në vitin 1120”. Sipas Kodikut të Mitropolisë së Korçës dhe Selasforit, ikonostasi i kishës “Burimi Jetëdhënës” është gdhendur nga Dhimitër Koleci në vitin 1756.

mjediset e muzeut. Grupi i punës, që u mor me platformën e muzeut, përbëhej nga Skënder Anamali, Andromaqi Gjergji dhe Pirro Thomo, me konsulencën shkencore të Aleks Budës. Kishës iu shtua një pjesë në anën perëndimore, e cila u përdor për të siguruar mjediset e punës së muzeut. Iu shtua edhe një pjesë në anën lindore, e cila u përdor për mjediset e ekspozitës së muzeut. Projekti i modifikimit të kishës në muze u hartua nga Pirro Thomo, Ali Muka dhe Skënder Luzati. Sipas Pirro Thomos, muzeu kishte sallën e ekspozitës së përhershme, sallën e konferencave, laboratorin e restaurimit të ikonave, laboratorin fotografik, mjediset e fondeve etj. Objektet, që qenë ekspozuar në muze, i përkisnin periudhës kohore nga shek. V deri në shek. XIX. Salla e përhershme e ekspozitës përmbante objekte prej guri, fragmente mozaikësh mesjetarë, ikona, objekte liturgjike kishtare, ikonostasin e kishës “Burimi Jetëdhënës”¹⁷ etj. Ekspozita ikonografike fillon me Onufrin dhe pasuesit e tij, Nikollën dhe Onufër Qipriotin¹⁸.

¹⁷ Nga ikonat e mëdha të ikonostasit mund të përmendim: Krishti Pandokrator, Shën Mëria me Krishtin, Joan Pagëzori, Mbledhja e Kryeengjëljeve etj. Ndër ikonat e brezit të sipërm të ikonostasit përmendim: Kryqëzimi i Krishtit, Darka Mistike, Mesipendikostia, E diela e Thomait, Shestja, Shërimi i ulokut, Lindja e Shën Mërisë, E diela e gjithë shenjtorëve, Shën Mëria me skena, Sinodi I Ekumenik etj. Kristofor Naslazi, *Kontributi i Theofan Popës shprehur nëpërmjet ikonave që ndodhen në Muzeun Kombëtar të Artit Mesjetar*, Tempulli, Nr. 3, Korçë, 2001, faqe 88; K. Balli, L. Gliozheni, *Theofan Popa dhe disa gjetje e konfirmime të reja për pikturën e vëllezërve Kostandin dhe Athanas Zografi nën dritën e veprës së tij shkencore*, 2000 vjet art e kulturë kishtare në Shqipëri, Tiranë, 2002, faqe 292.

¹⁸ Nga ikonat e Onufrin mund të përmendim: Krishti Pandokrator, Shën Mitri, Dyert e Bukura, Shën Konstandini dhe Elena, ikonat e kishës Evangjelistria në Berat: Kryqëzimi i Krishtit, Zbritja në Ferr, Lindja e Krishtit, Ngjallja e Llazarit, Shpërfytyrimi, Pagëzimi, Hyrja e Shën Mërisë në Tempull etj. Nga ikonat e Nikollës mund të veçojmë Shën Mëria, Shën

Më tej ka ikona të Kostandin Shpatarakut¹⁹, David Selenicës, vëllezërve Çetiri²⁰, vëllezërve Zografi, Mihal Anagnostit²¹ etj²². Ndiheza e Theofan Popës në fushën e ikonografisë ka qenë gjetja e mjaft ikonave të hershme. Nga ikonat që gjenden në Muzeun Kombëtar të Artit Mesjetar mund të përmendim Shën Kollin e Mborjes, Shën Kollin e kishës së Shën Gjergjit në Vithkuq, Shën Thanasin e Aleksandrisë, Shën Mërinë e Ballashtojës, Dyert e bukura të kishës së Maligradit, Shën Mëhillin e Oparit, Shën Mërinë e Maliqit etj²³. Fondi i ikonave dhe i objekteve liturgjike kishtarë

Mitri etj. Ndër ikonat që ka pikturuar Onufër Qiprioti dhe që janë të ekspozuara në muze mund të përmendim Krishti Pandokrator dhe Joan Pagëzori. Kristofor Naslazi, *Kontributi i Theofan Popës shprehur nëpërmjet ikonave që ndodhen në Muzeun Kombëtar të Artit Mesjetar*, Tempulli, Nr. 3, Korçë, 2001, faqe 87.

¹⁹ Nga ikonat e Shpatarakut mund të veçojmë: Darka mistike, Kryqëzimi i Krishtit, Krishti Pandokrator, Zbritja në ferr, Shën Mëhilli, Lindja e Shën Mërisë, Lindja e Krishtit, Ngjallja e Llazarit etj. Kristofor Naslazi, *Kontributi i Theofan Popës shprehur nëpërmjet ikonave që ndodhen në Muzeun Kombëtar të Artit Mesjetar*, Tempulli, Nr. 3, Korçë, 2001, faqe 88.

²⁰ Në muze janë rreth 20 ikona të realizuara nga vëllezërit Çetiri, nga të cilat mund të përmendim: Krishti Kryehierark, Shën Mëria me Krishtin, Shën Gjergji me skena etj. Kristofor Naslazi, *Kontributi i Theofan Popës shprehur nëpërmjet ikonave që ndodhen në Muzeun Kombëtar të Artit Mesjetar*, Tempulli, Nr. 3, Korçë, 2001, faqe 89.

²¹ Nga ikonat e Mihal e Dhimitër Anagnostit, që janë të ekspozuara në muze, mund të përmendim: Krishti Pandokrator, Shën Mëria me Krishtin, Shërimi i ulokut, Darka mistike, Mesipendikostia, Zbritja në ferr, Shën Joani në kryq, Mandili i Shenjtë etj. Kristofor Naslazi, *Kontributi i Theofan Popës shprehur nëpërmjet ikonave që ndodhen në Muzeun Kombëtar të Artit Mesjetar*, Tempulli, Nr. 3, Korçë, 2001, faqe 89.

²² Stilian Adhami, *Muzeologjia shqiptare*, Gervis, Tiranë, 2001, faqe 49-50.

²³ Kristofor Naslazi, *Kontributi i Theofan Popës shprehur nëpërmjet ikonave që ndodhen në Muzeun Kombëtar të Artit Mesjetar*, Tempulli, Nr. 3, Korçë 2001, faqe 86.

përbëhet nga 6500 objekte, të cilat janë sistemuar në katin e sipërm të muzeut në telajo me rrjetë teli. Muzeu është i pajisur me një laborator restaurimi²⁴. Në vitin 1991, salla kryesore e ekspozitës iu rikthye Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë dhe u përdor për celebrimin e shërbesave kishtarë. Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar është drejtuar nga personalitete të spikatura të kulturës shqiptare, ndër të cilët mund të përmendim: Avni Bilbili, Franklin Xega, Tatjana Caca, Kristofor Naslazi etj.

2-Me ikonat e mbledhura nga Theofan Popa²⁵ më 27 shkurt 1986, u hap në Berat muzeu “Onufri”. Funkzioni themelor i muzeut “Onufri” është të përçojë interpretimin e veprave të Onufrit, duke i dhënë një rol të rëndësishëm mbrojtjes së identitetit kombëtar. Muzeu u hap në mjediset e kishës “Fjetja e Shën Mërisë”²⁶ në kalanë e Beratit. Muzeu ka tri salla

²⁴ Disa nga restauratorët janë: Kristofor Naslazi, Koço Ristani, Tatjana Caca, Kristaq Balli, Genti Proko, Genti Postoli etj. Qendra e Restaurimit dhe e Studimit të Ikonave synon të formojë restauratorët e ardhshëm në fushën e ikonografisë. Nga aktivitetet më të rëndësishme të kësaj qendre është bashkëpunimi me Muzeun Bizantin të Selanikut, ku u restauruan rreth 88 ikona dhe u botua manuali i restaurimit të ikonave.

²⁵ Andrea Llukani, *Kontributi i Theofan Popës për muzeologjinë shqiptare*, Le Radici, Anno 16, n. 3, Settembre 2018, pagina 16.

²⁶ Kisha “Fjetja e Shën Mërisë” gjendet në kalanë e Beratit. Ajo ka qenë katedralja e Beratit. Pranë saj gjendej ndërtesa e mitropolisë. Kisha përbëhet nga naosi, nartekxi dhe hajati. Naosi është i tipit bazilikal me dy kupola dhe ka përmasat 20x10,9 metra. Mendohet se kisha është rindërtuar në rrënojat e një kisha të vjetër në vitin 1797. Këtë e vërteton mbishkrimi i gdhendur mbi gurin portal të kishës: “Viti 1797, muaji mars 9. U përtëri ky tempull i hirshëm i Fjetjes së Hyjlindëses me kontributin e të gjithëhirëshmit dhe të gjithëditurit të Beratit, Zotit Joasaf dhe me mendimin e klerikëve, të arkondëve dhe të gjithë të krishterëve të tjerë dhe të ktitorëve të tij (tempullit), për kujtimin e tyre. Nëse je mik, hyr duke u gëzuar; nëse je armik dhe i keq dhe plot me të këqija, ik larg nga kjo portë”. Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë, 1998, nr. 171, faqe 113.

kryesore, në të cilat janë ekspozuar ikonat më të mira të ikonografëve shqiptarë Onufrit, Nikollës, Onufër Qipriotit, David Selenicës, Kostandin Shpatarakut, Joan Çetirit dhe vëllezërve të tij. Muzeu përbëhet nga salla qendrore e kishës, nga altari dhe nga disa mjedise ndihmëse. Në mjediset e muzeut janë ekspozuar 77 ikona dhe rreth 40 objekte liturgjike kishtare. Objektet i përkasin periudhës kohore nga shek. XIV deri në shek. XIX. E veçanta në këtë muze është se janë ekspozuar tetë ikona të Onufrit, emrin e të cilit mban muzeu: “Shën Mëria me Krishtin”, “Deisis”, “Hyrja e Hyjlindëses në Tempull” etj²⁷.

Ikonostasi i kishës është gdhendur në dru are dhe është i larë me ar. Joan Çetiri ka realizuar me mjeshtëri ikonat e ikonostasit gjithsej, 27 ikona të vogla dhe 7 të mëdha²⁸. Në

²⁷ Stilian Adhami, Muzeologjia shqiptare, Gervis, Tiranë, 2001, faqe 117-118; Leon Çika, Ylli Drishti, *The Icons of Berat*, Mali Pleshti, Tiranë, 2003.

²⁸ Ikonat kryesore të ikonostasit janë: “Krishti Pandokrator”, “Shën Mëria”, “Joan Pagëzori” dhe “Fjetja e Hyjlindëses”. Brezi i sipërm ka ikonat e festave. Tematika e ikonave të tjera është nga Dhiata e Re: “Rrethprerja e Krishtit”, “Burimi Jetëdhënës”, “Mos më prek”, “Pagëzimi i Krishtit”, “Shërimi i të verbrit” etj. Në Dyert e bukura të ikonostasit janë të gdhendur dy dragoj. Në kulmin e derës gjendet një shqiponjë me kurorë sipër krerëve. Në derën veriore është pikturuar “Kryeengjëlli Mikael”. Në derën jugore është “Kryeengjëlli Gabriel”. Sipas dr. Gazmend Mukës, ikonat janë pikturuar prej pesë autorëve të ateliesë Çetiri, nën drejtimin e Joan Çetirit. Gjergj Prend Çetiri ka pikturuar ikonat “Lindja e Krishtit” dhe “Shpërfytyrimi”. Joan Çetiri ka pikturuar nëntë ikona: “Mos më prek”, “Shërimi i ulokut”, “Gruaja samaritane”, “E diela e të verbrit”, “Burimi jetëdhënës”, “Hyrja në Jerusalem”, “Rrethprerja”, “Vajtimi i mbivarrshëm” dhe “Pagëzimi i Krishtit”. Ndërsa firmën e Nikolla Gjergj Çetirit e mbajnë 14 ikona: “Lindja e Shën Mërisë”, “Fjetja e Shën Mërisë”, “Lindja e Pagëzorit”, “Mbledhja e apostujve” etj. Naum Çetiri ka pikturuar tri ikona: “Hyrja e Hyjlindës në tempull”, “Pesëdhjetorja” dhe një ikonë tjetër. Gjergj Nikollë Çetiri është autori i katër ikonave: “Ngjallja e Llazarit”, “Prekja e Thomait”, “Shestja” dhe “Gjysëmpendikostia”. Gazmend

pjesën e poshtme të amvonit është një mbishkrim, i cili vërtetohet se është gdhendur më 30 qershor të vitit 1849 nga usta Naumi nga Lavdari i Oparit²⁹. Në muze janë ekspozuar kapakë ungjilli, kryqe, temjanica dhe një antimis³⁰. Kapakët e ungjillit janë punuar nga Filip Athanasi³¹. Potiri i shenjtë i kishës është punuar në vitin 1757 nga argjendari Gjergj Episkioti³². Rreth dorezës prej argjendi të shklopit peshkopal është shkruar se është punuar në vitin 1745 nga Janko Voskopojari³³. Në një eksapiter është gdhendur mbishkrimi,

Muka, *Disa konsiderata për kontributin e Çetirëve në ikonat e katedrales "Fjetja e Shën Mërisë" në Berat*, Monumentet, 2/1990 (40), faqe 71-75.

²⁹ Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë, 1998, nr. 226, faqe 130.

³⁰ Mbi antimisin është stampuar mbishkrimi: "U shenjtërua nga Patriku i shumëlumtur dhe i shumëditur i qytetit të shenjtë të Jerusalemit dhe gjithë Palestinës, Zotit Partheni dhe i është dhuruar varrit të gjithëshenjtë dhe jetëdhënës në kohën e shumëlumturit Zotit Joasaf, me kujdesin dhe shpenzimet e gjithëoshënar Zotit Neofit prej Voskopojës, stampuar në këtë qytet prej murgut atë Damaskinoit nga Trika". Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë 1998, nr. 279, faqe 146-147; Marita Beci, *Disa vrojtime dhe sugjerime mbi gjendjen dhe problemet e ruajtjes së objekteve të restauruar në muzeun "Onufri"*, Monumentet, 2/1990 (40), faqe 109.

³¹ "Ky ungjill hyjnor u punua në kohën e Andreut dhe të Janit, bijve të priftit dhe në kohën e Nikollë Anastasit dhe të Kostandinit, bijve të Janit, me kontributin e tyre. Dhe u dhurua në tempullin e gjithënderuar të Fjetjes së Shën Mërisë, 1729 mars 30. Me dorën e Filip Athanasit, voskopojarit". Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë 1998, nr. 109, faqe 94.

³² "Potiri është i Mitropolisë së Beratit, punuar në kohën e papa Andresë, nga argjendari Gjergj Episkioti-1757". Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë 1998, nr. 130, faqe 101.

³³ "Ky skeepër (shkop peshkopal) është i shenjtit të Beratit, zotit Metodit, nga katundi Bubullimë dhe është 90 derhem, në vitin 1745, nga dora e Janko Voskopojarit". Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë 1998, nr. 123, faqe 99-100.

nga i cili mësojmë se është punuar në vitin 1860 nga Stergji Dhimitër Goga³⁴. Në një eksapter tjetër është shkruar se janë ripërtërirë në vitin 1860, kur kujdestar ka qenë Mit Zhapa³⁵.

Në hieroren e kishës “Fjetja e Shën Marisë” në Berat ndodhen lipsanët e Gorazhdit dhe të Angjellarit. Shën Gorazhdi ishte nga Moravia dhe e ushtroi veprimtarinë e tij misionare në Berat, ku edhe u martirizua. Lipsanët e shenjtorëve ruhen në dy arka³⁶. Mbi kapakun prej argjendi të arkës së lipsanëve të Gorazhdit dhe Angjellarit është shkruar: “Në kohën e kujdestarinë së zotit K. Veveçka. Me shpenzimet e kishës katedrale të Fjetjes së Shën Mërisë të Kalasë së Beratit, në kohën e peshkopatit të mitropolitit të Beratit, zotit Anthim, viti 1885, nëntor 11. Me dorën e gabriel D. Tiranasis, viti 1885, nëntor 11”³⁷. Një ikonë e kësaj kishe paraqet fjetjen e shenjtorëve sllavë. Ikona i përket ciklit të ikonave të mëdha të ikonostasit të kishës dhe është realizuar nga Joan Çetiri. Në qendër të ikonës paraqiten Gorazhdi dhe Angjellari. Arkitektura e banesave me çati të kuqe, kisha e vendosur në pjesën shkëmbore, lumi dhe ura sipër tij i referohen Beratit, qytetit ku gjenden dhe lipsanet e dy shenjtorëve sllavë.

Më 18 maj 2016, në Ditën Ndërkombëtare të Muzeve, në muzeun “Onufri” u hap një pavijon i ri “Thesare të fshehura”, me një seri ikonash të punuara nga Onufri, Nikolla, Onufër

³⁴ Argjendari, Stergji Dhimitër Goga 1860, qershor 21. Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë 1998, nr. 239, faqe 134.

³⁵ U përtërinë dy eksapterat e Fjetjes së Shën Mërisë kujdestar është Mit Zhapa 1860, qershor 21. Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë 1998, nr. 240, faqe 134-135.

³⁶ Kostas Nihoritit, *Tradita e kultit të shtatë shenjtorëve, 2000 vjet art dhe kulturë kishtarë në Shqipëri*, Tiranë 2003, faqe 87-90.

³⁷ Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Tiranë 1998, nr. 265, faqe 141.

Qiprioti etj, të cilat qenë në fondin e Drejtorisë Rajonale të Kulturës në Berat³⁸. Me interes qenë dy kuti prej argjendi me reliket e Angjellarit.

3-Një pjesë e madhe e ikonave, të mbledhura nga Theofan Popa³⁹, aktualisht gjendet në fondet e Muzeut Historik Kombëtar. Ikonat qenë grumbulluar fillimisht në Institutin e Monumenteve të Kulturës dhe në vitin 2004 kaluan në pronësi të Muzeut Historik Kombëtar⁴⁰. Fondi i ikonave përbëhet nga rreth 700 objekte: ikona, pjesë të ikonostaseve, objekte liturgjike etj. Me ikonat e përzgjedhura nga ky fond, në vitin 1999, në Muzeun Historik Kombëtar u hap pavijoni i ikonave pasbizantine, me rreth 70 ikona⁴¹. Në vitin 2017 pavijonit iu shtuan rreth 20 objekte liturgjike kishtarë⁴². Objektet përfshijnë një hark kohor që fillon nga shekulli XVI deri në fillim të shekullit XIX, që njihet si periudha e artit pasbizantin. Në pavijon ka ikona të ikonografëve: Onufri⁴³, Onufër Qiprioti⁴⁴,

³⁸ Dita Ndërkombëtare e Muzeve. Muzeu “Onufri” me pavijon të ri në 30-vjetorin e hapjes, Integrimi, 19 maj 2026, faqe 15.

³⁹ Andrea Llukani, *Kontributi i Theofan Popës për muzeologjinë shqiptare*, Le Radici, Anno 16, n. 3, Settembre 2018, pagina 16.

⁴⁰ Andrea Llukani, *Kontributi i teologut Theofan Popa në shpëtimin e mbishkrimeve dhe objekteve liturgjike kishtarë*, Le Radici, Anno 15, n. 5, Dicembre 2017, pagina 8.

⁴¹ Ylli Drishti, *Ikona. Koleksioni i Muzeut Historik Kombëtar Shek. XIV-XIX*, Mali Pleshti, Tiranë 2017; Ylli Drishti, *Icons. Collection of the National History Museum, Tirana, Albania 14th-19th centuries*, Mali Pleshti, Tirana 2017.

⁴² Dorian Koçi, Andrea Llukani, *Pavijoni i ikonave pasbizantine në Muzeun Historik Kombëtar*, (dorëshkrim i pabotuar), Tiranë, 2018, faqe 148-159.

⁴³ Në pavijonin e ikonave pasbizantine në Muzeun Historik Kombëtar është ekspozuar një ikonë e Onufrit: “Hyrja e Shën Mërisë në tempull”.

⁴⁴ Në pavijonin e ikonave janë ekspozuar shtatë ikona të Onufër Qipriotit: “Krishti Pandokrator”, “Fjetja e Shën Mërisë”, “Deisis”, “Pagëzimi në lumin Jordan” etj.

David Selenica⁴⁵, Kostandin Shpataraku⁴⁶, Kostandin Jeromonaku⁴⁷, Joan Athanasi⁴⁸, vëllezërit Zograf⁴⁹, vëllezërit Çetiri⁵⁰, anonimë⁵¹ dhe Mihal Anagnosti⁵².

Dosja e Theofan Popës

Në vitet 1974-1980 Theofani ka punuar pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës. Falë kulturës së lartë teologjike

⁴⁵ Në pavijon janë dy ikona: “Hyrja e Shën Mërisë në Tempull” dhe “Shpërfytyrimi”.

⁴⁶ Në pavijon gjendet ikona “Kryqëzimi i Krishtit”.

⁴⁷ Në pavijon janë ekspozuar ikonat: “Krishti Pandokrator”, “Shën Mëria me Krishtin”, “Apostujt Pjetër dhe Pavël”, “Ngritja e kryqit” dhe “Mbledhja e apostujve”.

⁴⁸ Në pavijon gjenden tri ikona të punuara nga Joan Athanasi: “Shën Mëria me Krishtin”, “Hyrja në Jerusalemin” dhe “Fjetja e Hyjlindëses”.

⁴⁹ Në pavijon janë disa ikona të tyre: “Mbledhja e kryeengjëljeve”, “Profeti Ilia me qerre” dhe “Shën Nikolla”.

⁵⁰ Në pavijon janë ekspozuar tri ikona të pikturuara nga vëllezërit Çetiri: “Shën Dhimitri me skena”, “Shën Gjergji” dhe “Profeti Ilia me qerre”.

⁵¹ Në pavijon janë ekspozuar ikona të mjaft piktorëve anonimë të shek. XVII-XVIII.

⁵² Në pavijonin e ikonave të Muzeut Historik Kombëtar gjenden disa ikona të pikturuara nga Mihal Anagnosti si edhe Dyert Mbretërore të kishës së Shën Mërisë në Elbasan. Tematika e ikonave është e ndryshme: 1-Kemi ikona shenjtorësh: “Tre Jerarkët”, “Shën Julita dhe Shën Marena”, “Ungjillorët Mateu, Marku e Luka”, “Shën Harallambi dhe Shën Trifoni”, “Shën Athanasi i Madh, Kirili i Aleksandrisë dhe Eftimi i Madh”, “Shën Gjergji”, “Ikona e gjithë shenjtorëve” etj. 2-Skena nga jeta e Krishtit: “Rrethprerja e Krishtit”, “Hyrja në Jerusalemin”, “E diela e të verbërit” etj. Ikonat e Mihal Anagnostit e kanë prejardhjen nga kisha e Shën Mërisë në Elbasan. Mbi ikonën e madhe e Krishtit është shkruar “Me dorën e Mihal Anagnostit nga Samarina”. Andrea Llukani, *Ikonat e Mihal Anagnostit në Muzeun Historik Kombëtar*, Studime Muzeologjike nr. 5, Tiranë 2015, faqe 53-55; Andrea Llukani, *Mihal Anagnosti, piktori i fundit i artit pasbizantin në Shqipëri*, Le Radici, Anno 13, n.3, Novembre 2015, pagina 23.

që e zotëronte me kompetencë, Theofan Popa ka bërë mjaft studime rreth artit mesjetar shqiptar, të cilat i ka botuar kryesisht në Buletinin e Shkencave Historike, që botonte Universiteti i Tiranës në atë kohë. Nga kolegët është vlerësuar si njeriu më i aftë përsa i përket artit kishtar⁵³. Disa nga kolegët kishin cmirë nga puna e tij kërkimore e shkencore e Theofanit, prandaj e akuzonin se shfrytëzonte detyrën për të bërë propagandë fetare. Në një mbledhje atë e pyetën: “A beson në Zot, apo jo?” Theofani iu përgjigj: “T’ju them se nuk besoj do t’ju gënjej dhe gënjeshtër nuk është në karakterin tim”⁵⁴.

Në dosjen⁵⁵ e tij ka shumë akuza të pabaza, si për shembull shfrytëzimi i punës shkencore për të bërë propagandë fetare në fshatrat ku shkante. Në një shkresë që mban datën 27.02.1978 drejtuar Komitetit të Partisë së Rrethit dhe personalisht shokut Xhelil Gjoni, me temë: “Mbi demaskimin e Theofan Popës” ndër të tjera shkruhej: *-Në ngarkim të Theofanit disponojmë materiale të vërtetuara se zhvillon veprimtari armiqësore në formën e agjitacionit dhe propagandë kundër partisë dhe pushtetit popullor, si dhe në kohë e vende të ndryshme ka propaganduar pikëpamje fetare. Gjatë ndjekjes që i bëmë Theofanit rezultoi se edhe i biri i tij Dhimitri, vjeç 22, student në vitin e dytë të Institutit Bujqësor, zhvillon veprimtari armiqësore kundër partisë dhe pushtetit. Duke parë se veprimtaria e tyre armiqësore u dokumentua me prova ligjore, vendosëm që Dhimitrin për efekt të*

⁵³ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Dosje formulare, Nr. 3328, faqe 109.

⁵⁴ Pirro Thomo, *Konseguent deri në fund në bindjet e tij*, Ngjallja, prill 2002, faqe 3.

⁵⁵ Andrea Llukani, *Dosja e Teologut Theofan Popa*, Global Challenge, Revistë Shkencore Periodike, Botim i Akademisë Diplomatike Shqiptare, Volumi VI, Numri 2, Tiranë, Maj 2017, faqe 95.

rrezikshmërisë shoqërore ta arrestojmë, ndërsa të atin, Theofanin si moshë e kaluar ta demaskojmë.

Kështu më 28.01.1978 pasi u arrestua Dhimitri, me porosi të Komitetit të Partisë së Rrethit të nesërmen më 29.01.1978 kryesia e frontit e bllokut nr. 3, të lagjes nr. 8 organizoi demaskimin e tij. Në këtë mbledhje ishin ftuar shokë nga Instituti i Histori Gjuhësisë, Instituti i Monumenteve të Kulturës si dhe disa studentë nga Instituti Bujqësor. Në mbledhje u lexua raporti që bënte fjalë për luftën e klasave, duke e konkretizuar me materialet në ngarkim të Theofanit, i cili nuk pranoi se kishte zhvilluar veprimtari armiqësore...⁵⁶. Organizata e frontit vendosi përjashtimin e Theofan Popës nga fronti. Gjithashtu të internohet nga Tirana dhe të gjykohet nga organet e drejtësisë. Të hiqet nga lagja nr. 8, pasi ndodhet në afërsi të bllokut dhe të vendoset në një lagje tjetër.

Mënjëherë pas demaskimit publik, Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë ngriti një komision të posaçëm për të shqyrtuar aktivitetin shkencor të Theofanit. Komisioni doli me raportin përkatës me temë: “Rreth veprimtarisë që ka kryer Theofan Popa për përvetësimin e materialeve arkivore shkencore dhe kishtarë”. Raporti është nënshkruar nga emra të njohur në fushën e historisë së asaj kohe, por për arsye etike nuk po i bëj publike. Ndër të tjera në raportin e datës 12 prill 1978 thuhej. -*Theofan Popa ka dëmtuar me qëllim arkivin shkencor të sektorit të arteve dhe veçanërisht artin kishtar shqiptar. Megjithëse i është bërë thirrje disa herë për të dorëzuar në sektor materialet arkivore shkencore: ikona, kryqe, daktilografime, përktitime, skeda, kartela, procesverbale, etj., por ai ka refuzuar. Në shtëpinë dhe bibliotekën e tij janë gjetur*

⁵⁶ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Dosje formulare, Nr. 3328, faqe 123; 124; 125.

të vjedhura dhe të përvetësuara nga bibliotekat, nga kishat dhe institucionet fetare dhe shkencore mbi 200 libra, vepra dhe enciklopedi të ndryshme. Këto janë të ndaluara si reaksionare për të mos qarkulluar në asnjë vend. Në literaturën e gjetur të vjedhur nga vetë ai janë gjetur edhe materiale me përmbajtje reaksionare, me rrezikshmëri antisocialiste shoqërore dhe shkencore. Nuk ka dorëzuar me qëllime të caktuara materialet dhe dokumentat arkivore për të dëmtuar punën. Në kisha dhe institucione fetare ka marrë materiale me vlera në kundërshtim me urdhërin dhe rregullin dhe detyrat që i ishin dhënë për ti marrë ato me dëftesa dhe procesverbale të rregullta. Ka refuzuar për të inventarizuar dhe dorëzuar në rregull materialet e marra nga kisha dhe institucione fetare. Nuk i ka dorëzuar sektorit, drejtorisë dhe llogarisë së Institutit të Historisë regjistrat, inventarët, dëftesat, procesverbalet dhe të tjera, që përmbanin gjendjen e materialeve të marra nga kishat. Ka edukuar fëmijët e tij në kundërshtim me vijën, politikën dhe ideologjinë e Partisë së Punës së Shqipërisë dhe të pushtetit popullor. Nuk ka treguar drejt të dhënat biografike të jetës së tij, si rasti që ka qenë në Angli dhe të tjera. Ka mbajtur në shtëpinë dhe bibliotekën e tij literaturë, libra dhe enciklopedi reaksionare revizioniste të ndaluara e antisocialiste. Ka propaganduar ide dhe mësimë fetare, të cilat janë të ndaluara me ligj në pushtetin tonë popullor. Për të gjitha këto dhe për ato që u ngritën në bllokun ku ai banon dhe në kolektivin e Institutit të Historisë del që veprimtaria e Theofan Popës është veprimtari armiqësore⁵⁷.

Në një raport të datës 10.07.1978 ndër të tjera përshkruhej gjendja shpirtërore e gruas së Theofanit, Elit, e cila pas atyre

⁵⁷ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Dosje formulare, Nr. 3328, faqe 130-131.

që i ndodhën që dobësuar shumë: -Kur ai (agjenti) e pyeti pse je dobësuar kaq shumë ajo i tha se si të mos dobësohem pas kaq fatkeqësive që na ranë mbi kokë. Dhimitraqi u arrestua dhe u dënua nga gjyqi me shtatë vjet burg, mua dhe vajzën na hoqën nga puna ku ishim dhe na caktuan punëtore krahu, Theofanin e demaskuan në mbledhjen e bllokut si propagandist fetar dhe i morën triskën e frontit dhe bibliotekën, bile blloku kishte kërkuar që ta hiqnin fare nga Tirana e ti thua përse u dobësove, bile jam shumë e fortë. Po Theofani si është e pyeti ai? Theofani mbahet më mirë se unë se ai mbështetet tek Zoti, e më jep kurajo dhe mua, megjithëse më kritikon vazhdimisht se për rrugën e keqe që kishte marrë Dhimitraqi fajtoje jam unë për arsye se i plotësoja të gjitha tekat dhe nuk e kontrolloja djalin, gjë që më bën të vuaj më shumë...⁵⁸.

Në raportin e datës 10.09.1980 agjenti ishte takuar me Theofanin, i cili i kishte folur për padrejtësitë që i janë bërë duke i arrestuar djalin. Ndër të tjera ai rrëfen: -Arrestimin e djalit, Theofani e quajti mashtrim me anë dëshmitarësh të rremë. Por kjo do ta kalisi djalin dhe do ta përgatiti për jetën, ashtu siç ka kërkuar Theofani me bindje të krishtera dhe forcën e Zotit, i cili shfaqet dhe ndërhyr në çdo çast të jetës së përditshme dhe krijon mrekullitë e tij, që shumë nga ne nuk i kuptojmë dhe nuk i shohim...⁵⁹.

Përfundime

Theofan Popa ka një veprimtari të admirueshme kërkimore dhe shkencore për evidentimin e vlerave historike të

⁵⁸ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Dosje formulare, Nr. 3328, faqe 132.

⁵⁹ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Dosje formulare, Nr. 3328, faqe 134.

monumenteve të kulturës të popullit shqiptar. Pas ndalimit të lirisë fetare më 22 mars 1967, Theofani pati privilegjin të sigurate një leje nga Universiteti i Tiranës për t'u marrë me grumbullimin e ikonave dhe objekteve të kultit nga kishat, që nuk qenë shpallur monumente kulture. Në shkresën e nënshruar nga Androkli Kostallari, që ka qenë drejtori i Institutit të Historisë e Gjuhësisë në atë kohë, thuhet se Theofan Popa duhet të grumbullonte edhe ikonat familjare në rrethet Durrës, Kavajë, Lushnje, Fier, Berat, Elbasan, Korçë, Pogradec, Ersekë etj. Duke shkuar fshat më fshat dhe kishë më kishë, Theofan Popa arriti të mblidhte qindra ikona dhe objekte liturgjike kishtare. Falë kulturës së lartë që zotëronte, Theofan Popa ka bërë mjaft studime rreth artit mesjetar shqiptar, të cilat i ka botuar kryesisht në Buletinin e Shkencave Historike, që botonte Universiteti i Tiranës në atë kohë. Nga specialisët është vlerësuar si njeriu më i aftë përsa i përket artit kishtar, por disa nga kolegët kishin cmirë nga puna kërkimore e Theofanit, prandaj e akuzonin se shfrytëzonte detyrën për të bërë propagandë fetare. Në dosjen e tij ka shumë akuza të pabaza. Më 29 janar 1978 kryesia e frontit e bllokut nr. 3, të lagjes nr. 8 organizoi demaskimin e tij publik. Në mbledhje u lexua raporti që bënte fjalë për luftën e klasave, duke e konkretizuar me materialet në ngarkim të Theofanit, i cili nuk pranoi se kishte zhvilluar veprimtari armiqësore. Mënjëherë pas demaskimit publik, më 12 prill 1978 Instituti i Historisë e Gjuhësisë ngriti një komision të posaçëm për të shqyrtuar “veprimtarinë armiqësore” të Theofanit. Raporti është nënshkruar nga emra të njohur në fushën e historisë së asaj kohe, por për arsye etike nuk po i bëj publike.

Në vitet e fundit të jetës së tij, Theofan Popa ka punuar me kohë të pjesshme në Arkivin e Shtetit. Koha e punës ishte tre orë në ditë, por Theofani nga entuziazmi që e karakterizonte

punonte edhe tre orë të tjera pa pagesë. Gjatë viteve që punoi në Arkivin e Shtetit (1983-1985) Theofan Popa hartoi një dorëshkrim me rreth 140 faqe: Katalog i kodikëve që ruhen në AQSH. Theofan Popa ndërroi jetë më 30 dhjetor 1985 në Tiranë, duke na lënë imazhin e një njeriu, që gjithë jetën e tij ia kushtoi ruajtjes së vlerave të trashëgimisë sonë kulturore.

Bibliografi

-Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Dosje formulare, Nr. 3328, faqe 49.

-Alma Gjermani, *Dhuruesit korçarë të shek. XIX*, Tempulli, Nr. 13, Korçë 2008, faqe 18-20.

-Andi Rëmbeci, *Botime të mbishkrimeve kishtare në Shqipëri*, Kërkim, Tiranë, 2010, faqe 136.

-Andrea Llukani, *Kontributi i teologut Theofan Popa në shpëtimin e mbishkrimeve dhe objekteve liturgjike kishtare*, Le Radici, Anno 15, n. 5, Dicembre 2017, pagina 8.

-Andrea Llukani, *Kontributi i Theofan Popës për muzeologjinë shqiptare*, Le Radici, Anno 16, n. 3, Settembre 2018, pagina 16.

-Andrea Llukani, *Dosja e Teologut Theofan Popa*, Global Challenge, Revistë Shkencore Periodike, Botim i Akademisë Diplomatike Shqiptare, Volumi VI, Numri 2, Tiranë, Maj 2017, faqe 95.

-Andrea Llukani, *Ikonat e Mihal Anagnostit në Muzeun Historik Kombëtar*, Studime Muzeologjike nr. 5, Tiranë 2015, faqe 53-55.

-Andrea Llukani, *Mihal Anagnosti, piktori i fundit i artit pasbizantin në Shqipëri*, Le Radici, Anno 13, n.3, Novembre 2015, pagina 23.

-Dorian Koçi, Andrea Llukani, *Pavijoni i ikonave pasbizantine në Muzeun Historik Kombëtar*, (dorëshkrim i

pabotuar), Tiranë, 2018.

-Dhimitër Beduli, *Theofan Popa-teolog dhe studiues i denjë i kishës dhe i kombit*, Ngjallja, janar 1995, faqe 6,8.

-Gazmend Muka, *Disa konsiderata për kontributin e Çetirëve në ikonat e katedrales “Fjetja e Shën Mërisë” në Berat*, Monumentet, 2/1990 (40), faqe 71-75.

-Kostas Nihoritis, *Tradita e kultit të shtatë shenjtorëve, 2000 vjet art dhe kulturë kishtare në Shqipëri*, Tiranë 2003, faqe 87-90.

-Kristofor Naslazi, *Kontributi i Theofan Popës shprehur nëpërmjet ikonave që ndodhen në Muzeun Kombëtar të Artit Mesjetar*, Tempulli, Nr. 3, Korçë, 2001, faqe 88.

-K. Balli, L. Gliozheni, *Theofan Popa dhe disa gjetje e konfirmime të reja për pikturën e vëllezërve Kostandin dhe Athanas Zografi nën dritën e veprës së tij shkencore*, 2000 vjet art e kulturë kishtare në Shqipëri, Tiranë, 2002, faqe 292.

-Leon Çika, Ylli Drishti, *The Icons of Berat*, Mali Pleshti, Tiranë, 2003.

-Marita Beci, *Disa vrojtime dhe sugjerime mbi gjendjen dhe problemet e ruajtjes së objekteve të restauruar në muzeun “Onufri”*, Monumentet, 2/1990 (40), faqe 109.

-Nasho Jorgaqi, *Udhëve të mërgimit*, Albin, Tiranë 1994.

-Pirro Thomo, *Konseguent deri në fund në bindjet e tij*, Ngjallja, prill 2002, faqe 3.

-Stilian Adhami, *Muzeologjia shqiptare*, Gervis, Tiranë, 2001.

-Theofan Popa, *Mbishkrime të kishave në Shqipëri*, Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë, Tiranë 1998.

-Theofan Popa, *Miniatura dhe piktura mesjetare në Shqipëri*, Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë, Tiranë 2006.

-Theofan Popa, *Piktor Kostandini prej Shpatit*, Buletin për

shkencat shoqërore, Nr. 1, 1955, faqe 211-214.

-Theofan Popa, *Onufri, piktor i madh shqiptar i shek. XVI*, Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, seria shkencat shoqërore, Nr. 1, 1955, faqe 208-219.

-Theofan Popa, *Mbishkrimet e kishave të Shqipërisë si burime historike*, Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, seria shkencat shoqërore, Nr. 1, 1958, faqe 218-250.

-Theofan Popa, *Piktorët korçarë Kostandin dhe Athanas Zografi dhe afresket e tyre me skenat e apokalipsit*, Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, seria shkencat shoqërore, Nr. 1, 1959, faqe 23-48.

-Theofan Popa, *Disa mbishkrime të kishave të Shën Mërisë në Maligrad dhe të Ristozit në Mborje*, Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, seria shkencat shoqërore, Nr. 2, 1959, faqe 257-262.

-Theofan Popa, *Piktorët grabovarë Çetiri nga familja Katro*, Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, seria shkencat shoqërore, Nr. 3, 1960, faqe 121-145.

-Theofan Popa, *Piktura të tjera të piktor Nikollës, zbuluar në Kurjan të Fierit*, Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, seria shkencat shoqërore, Nr. 4, 1960, faqe 223-229.

-Theofan Popa, *Onufri, piktori më i madh shqiptar i shek. XVI*, Puna, 18 tetor 1960.

-Theofan Popa, *Onufri, piktori më i madh mesjetar në Shqipëri*, Zëri i Rinisë, 28 tetor 1961.

-Theofan Popa, *Piktor Onufri dhe gjendja e artit të pikturës gjatë mesjetës*, Nëntori, Nr. 4, 1962.

-Theofan Popa, *Onufri, ikonograf i shquar shqiptar*, Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, seria shkencat shoqërore, Nr. 1, 1962, faqe 54-75.

-Theofan Popa, *Kostandin Shpataraku, piktori shqiptar i*

shekullit XVIII, Nëntori, Nr. 3, 1965.

-Theofan Popa, *Të dhëna të reja rreth piktor Onufrit*, Studime historike, Nr.1, 1966, faqe 141-145.

-Theofan Popa, *Piktor Onufri, personalitet i rëndësishëm i pikturës mesjetare shqiptare*, Studime shqiptare, Nr. 1, 1966.

-Ylli Drishti, *Ikona. Koleksioni i Muzeut Historik Kombëtar Shek. XIV-XIX*, Mali Pleshti, Tiranë 2017.